

VENDIM
Nr. 201, datë 4.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 440, DATË 19.7.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË KREDITIMIT
STUDENTOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 440, datë 19.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, fjalët “... brenda muajit janar ...” zëvendësohen me “... përpara fillimit të vitit akademik ...”.

b) Shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Financimi i kredisë bëhet me këste, të paktën dy herë në vit. Financimi i kështit të parë për çdo vit akademik duhet të realizohet pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka frekuentuar procesin mësimor. Financimi i kësteve pasardhëse realizohet pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të atij viti akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;

ç) Shlyerja e detyrimeve financiare nga studenti kredimarrës fillon jo më herët se kohëzgjatja normale e programit të studimit, për të cilin studenti ka nënshkruar kontratën e kredisë, por me kërkesë të studentit kredimarrës, shlyerja e detyrimeve financiare mund të realizohet dhe para përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve.”.

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Studenti, i cili është subjekt i përfitimeve prej akteve të tjera ligjore, apo nënligjore që mbështesin studentin me bursa, mbështetje financiare apo përjashtim nga tarifat vjetore të shkollimit, dhe studenti, që ndjek një program të dytë studimi, nuk ka të drejtë të aplikojë për kredi studentore.

Studenti ka të drejtë të aplikojë për kredi studentore pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i vitit akademik, duke bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton regjistrimin si student në institucionin përkatës të arsimit të lartë.”.

ç) Paragrafi i parë i pikës 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë shqyrton kërkesat e studentëve për kredi studentore, sipas afatit të përcaktuar me vendim të Bordit Drejtues në bazë të kriterëve, si më poshtë vijon: ...”.

d) Në pikën 8, fjalët “... brenda afatit të përcaktuar në pikën e mësipërme ...” zëvendësohen me “... sipas afatit të përcaktuar me vendim të Bordit Drejtues ...”.

dh) Në pikën 9, fjalët “... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ...” zëvendësohen me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve ...”.

e) Në pikën 11, fjalët “... brenda muajit maj ...” zëvendësohen me “... sipas afatit të përcaktuar me vendim të Bordit Drejtues ...”.

ë) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Mbulimi i shpenzimeve të interesave të kredive studentore realizohet nga fonde buxhetore grant të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për të financuar normën e interesit të kredive studentore në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet bankës/bankave të nivelit të dytë dhe AKFAL-it, me vendim të Bordit Drejtues, miraton shumën e fondeve grant që akordohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Shuma e fondeve vjetore për mbulimin e shpenzimeve të interesave të kredive studentore përlogaritet deri në masën 0.5% (zero pikë pesë) të shumës vjetore të grantit të mësimdhënies.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku